



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:153435

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05406402

CP.nr.767/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, përmes gjyqtarit individual Fuad Haliti dhe me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në lëndën përbarimore të kreditorit F.K nga Mitrovica të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. Valon Mehmeti nga Mitrovica, ndaj debitorit ndërmarrja Trepça Sh.A me seli në Mitrovicë, jashtë seancës gjyqësore me datë 04.03.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përbarimore e kreditorit F.K nga Mitrovica, ndaj debitorit ndërmarrja Trepça Sh.A me seli në Mitrovicë.

Arsyetim

Me aktvendimin e kësaj gjykate CP.nr.767/21 i datës 10.06.2021, është caktuar përbarimi sipas propozimit të kreditorit F.K, ndaj debitorit ndërmarrja Trepça Sh.A me seli në Mitrovicë.

Me parashtresën e datës 23.08.2023, i autorizuari i kreditorit, e ka njoftuar gjykatën se debitori e ka përmbushur obligimin ndaj kreditorit.

Gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 i Ligjit për Procedurën Përbarimore e përfundoj procedurën përbarimore pasi që detyrimi i debitorit ndaj kreditorit është përmbushur.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CP.nr.767/2021, datë 04.03.2024

GJYQTARI
Fuad Haliti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditore nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.